

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6736
E enjte, 20 tetor 2022
çmimi 0.40

ShBA-ja kërkon nga
Kosova dhe Serbia t'i
shmangin tensionet
për targat | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUARI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) PËR BALLKANIN
PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, KA TAKUAR TË MËRKURËN NË PRISHTINË
PRESIDENTEN VJOSA OSMANI DHE KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI | FAQE 4-5

ESCOBAR: E MBËSHTESIM KOSOVËN NË TË GJITHA ASPIRATAT EUROATLANTIKE



I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se ekziston një partneritet i palëkundshëm ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, me ç'rast ka theksuar se me zyrtarët shtetërorë të Kosovës në Prishtinë ka diskutuar për marrëdhëniet

me Serbinë, për implikimet rajonale nga dialogu dhe për mbështetjen e ShBA-së për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Ai ka thënë se në këtë kohë krize është e rëndësishme që Kosova të rreshtohet me vlerat evropiane

OPINION



DRITON KUKA E MAJLINDA
KELMENDI VIZITOJNË
ISH-UDHËHEQËSIT E UÇK-së
NË HAGË, MAVRAJ: KJO
VIZITË DO T'I NDEROJË
STRATEGËT E LIRISË | F. 5

AKTUALE

PUTINI SHPALL GJENDJE LUFTE
NË KATËR RAJONET
E ANEKSUARA UKRAINASE | F. 2

AKSION PËR FAJDE NË GJAKOVË,
ARRESTOHEN PESË PERSONA | F. 6

ABDIXHIKU: ÇFARË ËSHTË BLERË ME
100 EURO VITIN E KALUAR,
SOT BLIHET ME 150 EURO | F. 8

EKONOMI

SA JANË REALE ARRITJET
EKONOMIKE QË I TRUMBETON
QEVERIA? | F. 7

SINDIKATAT KRITIKOJNË
PROJEKTLIGJIN PËR PAGAT | F. 8

SPORT



PRISHTINA MPOSHT DRITËN,
MALISHEVA FERIZAJN | F. 10



AAK-ja
KA TRI
PROPOZIME
PËR KRIZËN
ENERGJETIKE
NË VEND



IVAN TODOSIJEVIQI DËNOHET ME
NJË VIT BURGIM LIDHUR ME
DEKLARATAT PËR REÇAKUN | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Putini shpall gjendje lufte në katër rajonet e aneksuara ukrainase

MOSKË, 19 TETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se ka shpallur gjendje lufte në rajonet ukrainase të Donjeckut, Luhanskut, Hersonit dhe Zaporizhjes, duke u dhënë fuqi shtesë krerëve të rajoneve të Rusisë. Këto katër rajone ukrainase Moska pretendon se i ka aneksuar. "Kam nënshkruar dekretin për shpalljen e gjendjes së luftës në këto katër subjekte të Federatës Ruse", tha Putini gjatë takimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Rusisë që u transmetua drejtpërdrejt. Kremlini më pas publikoi dekretin ku thuhet se gjendja e luftës do të hyjë në fuqi mëngjesin e 20 tetorit. Putini nuk tregoi se çfarë hapash konkretë do të ndërmerren pas shpalljes së gjendjes së luftës. Dekreti i tij u jep agjencive të zbatimit të ligjit tri ditë afat për të paraqitur propozime specifike. "Ne po punojmë që t'i zgjidhim çështjet e vështira që ta mbrojmë sigurinë e Rusisë dhe të

garantojmë të ardhme të sigurt, t'i mbrojmë njerëzit tanë. Ata që janë në vijat e luftës ose janë duke u trajnuar për luftë në qendrat trajnuese, duhet ta ndiejnë mbështetjen tonë dhe duhet të dinë se kanë pas vetes shtetin dhe popullatën", shtoi ai. Dhoma e Lartë e Parlamentit rus pritet të mblidhet shpejt për ta miratuar vendimin e Putinit për shpalljen e gjendjes së luftës. Pritet që kjo masë ta përfshijë kufizimin e udhëtimeve dhe tubimeve publike, por edhe dhënien e fuqive më të mëdha për autoritetet e zbatimit të ligjit. Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt. Pasi Moska mbajti referendume të rreme në katër rajonet ukrainase, më 30 shtator Putini nënshkroi dekretin për aneksimin e tyre. Kievi dhe Perëndimi e kanë cilësuar vendim të paligjshëm aneksimin e katër rajoneve ukrainase, që janë pjesërisht të pushtuara nga forcat ruse.



Rusia nis evakuimet nga jugu i Ukrainës

KIEV, 19 TETOR - Dhjetëra mijëra civilë, dhe zyrtarë të emëruar nga Rusia, janë duke u tërhequr nga rajoni jugor ukrainas i Hersonit, ka thënë lideri i instaluar nga Rusia, Vladimir Saldo. Sipas tij, 50-60 000 civilë do të largohen nga katër qytezat afër lumit Dnjepër përmes një "zhvendosjeje të organizuar". Të gjitha departamentet e emëruara nga Rusia në Herson besohet se do ta kalojnë lumin. Televizionet ruse kanë shfaqur disa njerëz duke u mbledhur afër lumit. Ende nuk dihet sa prej tyre do të shpërngulen, mirëpo transferimi, apo dëbimi i civilëve nga një forcë pushtuese, prej një territori të pushtuar, konsiderohet krim lufte. Në orët e mbrëmjes të së hënës, komandanti i ri rus në Ukrainë, generali Sergei Surovikin, e ka përshkruar situatën në Herson të vështirë. Një tjetër zyrtar i instaluar nga



Rusia, Kirill Stremousov, ka paralajmëruar banorët e Hersonit se forcat ukrainase do t'i nisin sulmet në qytet "në një të ardhme

shumë të afërt". Hersoni ka qenë qyteti i parë i madh ukrainas që ka rënë në duart e forcave ruse pas nisjes së

luftës së Rusisë në Ukrainë në fund të muajit shkurt. Megjithatë, brenda javësh ushtria ukrainase ka çliruar një pjesë të territorit dhe

i ka shtyrë forcat ushtarake ruse afër lumit Dnjepër, duke i kërcënuar me bllokim. Kremlini tani pretendon se Hersoni dhe tri rajone të tjera, Donjecku, Luhansku dhe Zaporizhja, janë pjesë e Rusisë, ndonëse diçka e tillë është kundërshtuar në nivel ndërkombëtar. Rusia ka organizuar të ashtuquajturat referendume për bashkim në këto rajone, hap që është konsideruar i rremë nga Perëndimi. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus, Vladimir Putin, e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Rreth 300 fluturime të anuluar si pasojë e grevës në "Eurowings"

Dyseldorf, 19 tetor - Rreth 300 fluturime të kompanisë "Eurowings" janë anuluar të mërkurën, sipas kompanisë amë "Lufthansa", si pasojë e grevës së pilotëve të cilët janë duke kërkuar kushte më të mira të punës. Të mërkurën është shënuar dita e tretë dhe e fundit e grevës

për këtë javë. Greva ka prekur dy të tretat e 450 fluturimeve të planifikuara. "Ne presim që t'iu kthehemi operacioneve normale të fluturimit të enjten", kanë thënë nga "Lufthansa". Një zëdhënës i sindikatës së pilotëve ka thënë se grevat e planifikuara për këtë javë do të

përfundojnë në mesnatë. Ende nuk është e qartë nëse palët do të kthehen në tavolinën negociuese. Një prej pikave kyçe ka qenë e lidhur me numrin e ditëve të lira të pushimit. Pilotët kanë kërkuar 14 ditë pushim, mirëpo kompania ajrore aktualisht ofron 10.



ShBA-ja kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i shmangin tensionet për targat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 TETOR - Shtetet e Bashkuara u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i shmangin tensionet për çështjen e targave teksa përfaqësuesit e Prishtinës dhe të Beogradit fajësuan njëri-tjetrin për tensionet e krijuara në veri të Kosovës në fund të korrikut dhe fillim të gushtit.

Në takim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku u prezantua raporti gjashtëmuajor për Kosovën, ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, tha më 18 tetor se kërcënimi për stabilitetin dhe paqen nuk ka ardhur nga Kosova, por nga Serbia. "Kosova nuk ka provokuar, Kosova ka insistuar që Serbia t'i përmbahet marrëveshjes që ka nënshkruar vetë", ka thënë Gërvalla duke iu referuar marrëveshjes për lëvizjen e lirë, që përmbante edhe pikën për lëshimin e një dokumenti për hyrje/dalje për shtetasit e Kosovës dhe Serbisë.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për lëshimin e dokumentit për hyrje/dalje, por edhe ai për rirregjistrimin e targave, rritën tensionet në pikëkalimet kufitare

në veri të Kosovës më 31 korrik dhe 1 gusht, me serbët lokalë që bllokuan rrugët.

Kjo bëri që Kosova ta shtynte për një muaj zbatimin e vendimeve, ndërkohë Prishtina dhe Beogradi u pajtuan që ta heqin krejtësisht dokumentin për hyrje/dalje, ndërkaq vendimi për targat nisi së zbatuari më 1 shtator.

Por, ministri i Jashtëm serb, Nikolla Sellaković, ka thënë se veprimet, siç i quajti ai, "të njëanshme" të Kosovës, sa i përket çështjes së rirregjistrimit të targave, nga ato që lëshohen nga Serbia në RKS (Republika e Kosovës), kanë për qëllim "diskriminimin" e serbëve.

Ai ka thënë se fakti që ka shumë pak persona që kanë rirregjistruar makinat e tyre tregon se Prishtina nuk ka mbështetje për këtë pikë.

Qytetarët serbë në Kosovë, që kanë makinat me targa të lëshuara nga Serbia, mund t'i rirregjistrojnë ato në RKS deri në fund të tetorit.

Pikërisht përfundimi i këtij afati bëri që ministrja Gërvalla të paralajmërojë se Serbia po përgatit nxitje "të dhunës". "Serbët ekstremistë po ndjekin dhe po frikësojnë në mënyrë brutale bashkëqytetarët e tyre duke ua djegur edhe veturat që kanë ndërruar targat", ka



deklaruar Gërvalla. "Ne kemi inkurajuar këtë këshill dhe bashkësinë ndërkombëtare që ta shtyjë Serbinë që ta ndalë këtë rrugëtim të rrezikshëm të nxitjes së çrregullimeve dhe dhunës në fund të këtij muaji", ka shtuar ajo. Por, Sellaković tha se "retorika e vrazhdë e Kosovës" paraqet "hapa destabilizues" sa i përket vendimeve të marra për rirregjistrimin e makinave.

Ndërkaq përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara në OKB ka theksuar se përmes dialogut, Kosova dhe Serbia arritën nënshkrimin e Udhërrëfyesit për Marrëveshjen për energjinë dhe në mënyrë paqësore zgjidhën çështjen e dokumentit për hyrje/dalje. "Ne i inkurajojmë fuqishëm Kosovën dhe Serbinë që t'i mbajnë tensionet e ulëta duke u fokusuar në progres dhe dialog dhe duke

shmangur retorikën nxitëse. Ne u bëjmë thirrje palëve që të punojnë me partnerët amerikanë dhe evropianë për zbatimin e Udhërrëfyesit për Energjinë dhe t'i shmangin tensionet për targat", ka pohuar përfaqësuesi i ShBA-së. Ndërkaq ambasadorja e Francës ka theksuar se "çfarëdo veprimi i njëanshëm që mund të nxisë tensione, duhet të shmangët".

Ivan Todosijeviqi dënohet me një vit burgim lidhur me deklaratat për Reçakun

PRISHTINË, 19 TETOR - Zyrtari i Listës Serbe, Ivan Todosijeviq, është dënuar të mërkurën me një vit burgim në seancën e rigjyimit për "përhapje të urrejtjes dhe jotolerancës", ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" avokati e tij, Nebojsa Vllajiq.

Ai është dënuar fillimisht me dy vjet burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, por Gjykata Supreme e Kosovës e pati kthyer rastin në rigjykim në fund të dhjetorit të vitit të kaluar.

Todosijeviq pati deklaruar në mars të vitit 2019 se "arsyeja për agresionin e NATO-s ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare në Kosovë dhe masakra e trilluar e Reçakut".

Deklarata e tij përkonte me 20-vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s në caqet e ish-ushtrisë jugosllave, fushatë kjo që i dha fund luftës në Kosovë.

Ai në atëkohë mbante pozitën e ministrit të Administratës dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Kosovës, por u shkarkua nga kryeministri i atëhershëm i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj.

Masakra e Reçakut njihet si një nga ngjarjet që ka shënuar kthesë në diplomacinë



ndërkombëtare në raport me Serbinë dhe Kosovën, duke u paraprirë proceseve që çuan te fushata e bombardimeve të NATO-s kundër njerëzimit" nga ish-shefi

ushtarake të Serbisë. Vrasja e 45 civilëve shqiptarë nga forcat paramilitare serbe në Reçak ishte cilësuar "krim kundër njerëzimit" nga ish-shefi

i Misionit Verifikues në Kosovë, ambasadori William Walker. Në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në Kosovë në shkurt 2021, Todosijeviq mori

mbështetjen e votuesve dhe u zgjodh një nga dhjetë deputetët e Listës Serbe. Ai mban edhe pozitën e kryetarit të Zveçanit në kuadër të strukturave paralele serbe në Kosovë.

Atij i është shtyrë vuajtja e dënimit me burgim dy herë më 2021: herën e parë për shkak se "ishte jashtë vendit", herën e dytë për "arsye shëndetësore".

Todosijeviq është dashur të paraqitej për herë të parë për ta vuajtur dënimin me burgim më 6 tetor 2021. Në disa raste, Todosijeviq është "mbrojtur" nga Lista Serbe, e cila ka kërcënuar se do të japë dorëheqje nga institucionet nëse ai merr dënim të plotfuqishëm.

Në mbrojtje të tij shpeshherë del edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ai e ka përmendur Todosijeviqin edhe më 13 shtator, kur u ka folur deputetëve për dialogun me Kosovën. "Dua t'ju kujtoj Ivan Todosijeviqin... i dënuar me dy vjet, sepse tha se Raçaku ishte mashtrim. Unë e thashë atë gjë po të njëjtën ditë. Dua ta marr anën e lirisë së shprehjes së mendimit", ka thënë Vuçiq, duke shtuar se serbët në Kosovë nuk e kanë lirinë e shprehjes dhe se ata përballen me aktakuza "të fshehura apo publike".



Foto: Zyra e Kryeministrit të Kosovës

I DËRGUARI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, KA TAKUAR TË MËRKURËN NË PRISHTINË PRESIDENTEN VJOSA OSMANI DHE KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI

Escobar: E mbështesim Kosovën në të gjitha aspiratat euroatlantike

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se ekziston një partneritet i palëkundshëm ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, me ç'rast ka theksuar se me zyrtarët shtetërorë të Kosovës në Prishtinë ka diskutuar për marrëdhëniet me Serbinë, për implikimet rajonale nga dialogu dhe për mbështetjen e ShBA-së për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Ai ka thënë se në këtë kohë krize është e rëndësishme që Kosova të rreshtohet me vlerat evropiane

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 19 TETOR - I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Kosovë. Escobari është takuar me presidenten Vjosa Osmani dhe me kryeministrin Albin Kurti.

Në takimet e veçanta që i ka

pasur me zyrtarët e lartë shtetërorë të Kosovës, zyrtari i lartë amerikan ka biseduar për raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së, për dialogun me Serbinë dhe për proceset integruese të Kosovës.

Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit të ShBA-së, Gabriel Escobar, fillimisht ka takuar Osmanin e pas takimit ata kanë mbajtur një konferencë për medie.

Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova ka qenë dhe është palë konstruktive në dialogun me Serbinë dhe ka gatishmëri ta rrisë angazhimin. "Shfrytëzova rastin për ta shprehur pakënaqësinë tonë për moszbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara nga ana e Serbisë, duke përfshirë në veçanti refuzimin e vazhdueshëm nga ana e tyre për shpërbërjen e strukturave ilegale dhe kriminale, të cilat vazhdojnë t'i kërcënojnë edhe frikësojnë serbët e Kosovës dhe udhëhiqen nga individë të sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara", ka thënë Osmani.

Sipas saj, përveç refuzimit, Serbia vazhdon "t'i mbështesë ato financiarisht".

Ajo ka përmendur se angazhimi amerikan është i pazëvendësueshëm për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në rajon dhe ka thënë se Kosova po punon për anëtarësim në

strukturat euroatlantike.

Escobari, në anën tjetër, ka thënë se ShBA-ja e mbështet rrugën e Kosovës në këtë drejtim. "Është një miqësi dhe partneritet që mbështetet jo vetëm në interesin e përbashkët, por në vlerat e përbashkëta dhe në këtë drejtim dëshiroja t'i shpreh presidentes mbështetjen e vazhdueshme amerikane për aspiratën euroatlantike të Kosovës. Unë i falënderoj për solidaritetin e tyre në kohën e krizës në Evropë dhe nevojën për të kërkuar mënyra për të thelluar këtë partneritet duke përfshirë mbështetjen tonë për përfshirjen e Kosovës në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian", ka deklaruar Escobar.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti.

Po pas takimit të dy kanë

mbajtur një konferencë për medie.

Kurti i ka uruar Escobarit mirëseardhje në Prishtinë, duke theksuar se është një kontribuues i madh për paqen, sigurinë dhe demokratizimin jo vetëm të Kosovës, por të gjithë rajonit. Ai ka treguar se me zyrtarin e lartë amerikan kanë folur për raportet e dy vendeve, për temat aktuale në Kosovë si energjia dhe dialogu me Serbinë.

Kryeministri Kurti ka thënë se Republika e Kosovës ka treguar se është palë konstruktive dhe kreative në procesin e dialogut. "Me Escobarin folëm për rëndësinë dhe peshën e raporteve tona dypalëshe, partneritetin ndërmjet vendeve tona, për progresin dhe reformat në Kosovë, ballafaqimin me krizën energjetike dhe për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e për procesin e dialogut dhe rrugën përpara."

Driton Kuka e Majlinda Kelmendi vizitojnë ish-udhëheqësit e UÇK-së në Hagë, Mavraj: Kjo vizitë do t'i nderojë strategët e lirisë

Dy ikonat e xhudos në Kosovë, Driton Kuka e Majlinda Kelmendi, janë nisur për në Holandë.

Vizitën në këtë shtet Kuka e Kelmendi do ta shfrytëzojnë edhe për t'i takuar ish-liderët e UÇK-së që po gjykohen në Hagë. Profesori universitar, publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka përshëndetur vizitën që do ta bëjnë Kuka e Kelmendi te ish-udhëheqësit e UÇK-së. Mavraj ka shkruar në "Facebook" se kjo vizitë do t'i nderojë strategët e lirisë.



"Rrallë bëj share. Ndonjëherë është e domosdoshme nga ndërgjegjja. Qe patëm folur për pelegrinazhin në Hagë... Majlinda jonë dhe Driton Toni Kuka ynë janë për rrugë dhe dua

t'i përshëndes për zemërsisht. Ndonjëherë me vetëm një gjest tregojmë shpirtin tonë. Është njerëzillëk solidariteti me njerëzit në ditët e tyre të vështira pasi që rrezikuan mijëra herë jetët e tyre për lirinë e miliona të tjerëve! Kjo vizitë do t'i nderojë e emocionojë strategët e lirisë", ka shkruar Mavraj.

Kuka e Kelmendi të enjten do t'i takojnë ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, ish-deputetin Rexhep Selimi dhe Nasim Haradinajn.



Përmes gatishmërisë për takime, vullnetit për marrëveshje dhe propozimeve konkrete që japin, Republika e Kosovës ka treguar se është palë konstruktive dhe kreative në procesin e dialogut. Jemi në gathëm dhe të përkushtuar për arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme për normalizim të plotë të marrëdhënieve me njohjen reciproke në qendër. E mirëpresim gjithmonë interesimin dhe mbështetjen e ShBA-së në këtë proces. Me ShBA-në jemi aleatë në vlera dhe partnerë në qëllime. Rreshtimi i menjëhershëm i Kosovës me ShBA-në, me BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar, për vendosjen e sanksioneve kundër Federatës Ruse dhe në mbështetje të pazezërësive për Ukrainën dhe popullin e saj, përbëjnë dëshmi të aleancës dhe partneritetit tonë dhe, në të njëjtën kohë, dallimin me të gjithë ata të tjerët që nuk u rreshtuan siç duhet në anën e të vërtetës dhe të drejtës", ka thënë Kurti.

Ndërkaq i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se partneriteti ShBA - Kosovë është i palëkundur. Ai ka thënë se ShBA-ja e mbështet pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. "Është një partneritet i palëkundshëm ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së. Diskutoam për marrëdhëniet me Serbinë, për implikimet rajonale nga dialogu dhe për mbështetjen e ShBA-së për pavarësinë, sovranitetin dhe sigurinë tuaj. Në këtë kohë krize është e rëndësishme të rreshtoheni me vlerat evropiane. ShBA-ja e mbështet Kosovën në

të gjitha aspiratat euroatlantike", ka thënë Escobari.

Vizita e të dërguarit amerikan po ndodh në një kohë kur po përfillet për një shtim të ritmit të procesit të bisedimeve Kosovë - Serbi pas një nisme franko-gjermane për një marrëveshje mes palëve. Ndonëse Parisi dhe Berlina nuk kanë folur për nismën, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka theksuar se Franca dhe Gjermania kanë paraqitur një dokument me të cilin kërkojnë që Serbia ta lejojë anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por pa e njohur pavarësinë e saj. Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se po diskutohen modele të ndryshme, por nuk ka diçka përfundimtare apo vendimtare që do të mund të thuhet se ky është propozimi franko-gjerman. "Nuk ka diçka përfundimtare dhe aq më pak vendimtare që do të mund të thuhet se ky është propozimi francezo-gjerman dhe, rrjedhimisht, 'diskutojeni tash dhe jepni vërejtjet'. Më shumë ka, si të them, ide që qarkullojnë, Berlin, Bruksel, Uashington, por edhe Londër, Romë e Paris, si dhe Beograd dhe Prishtinë", pati deklaruar Kurti dhe shtuar se për shkak të konfidencialitetit të bisedimeve, nuk mund t'i hedhë në opinion idetë me të cilat testohen palët nga zyrtarët dhe diplomatët e ndryshëm.

"Mungesa e frikshme e transparencës në dialog"

Lëvizja për Bashkim përmes një komunikate për medie ka theksuar se kohën e fundit janë

Pas Prishtinës, Escobari do ta vizitojë Beogradin

I dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, më 20 tetor do të takohet në Beograd me kryeministren serbe Ana Bërnabiq dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Siç është paralajmëruar, Escobari do të zhvillojë takim me Vuçiqin në Presidencën serbe në orën 09:30 të enjten, ndërkaq dy orë më vonë do të takohet me Bërnabiqin në qeverinë serbe.

Pas këtyre takimeve nuk është paralajmëruar se do të ketë deklarata për medie.

shtuar vizitat e emisarëve të BE-së e të ShBA-së të ngarkuar me ndërmjetësimin e dialogut Kosovë - Serbi.

Përveç kësaj, sipas LB-së, tanimë është e njohur publikisht edhe ekzistenca e një plani franko-gjerman për t'u dhënë fund bisedimeve Kosovë - Serbi, me synimin që të përmbillet me një marrëveshje përfundimtare në mes të këtyre dy vendeve. "Madje u tha edhe publikisht se ka një marrëveshje në mes të palëve që ky plan të mos bëhet publik. Edhe pse Qeveria e Kosovës fillimisht e mohoi ekzistencën e këtij plani, tani e thotë hapur se ai plan ekziston, por nuk e ka thënë as edhe një fjalë të vetme për përmbajtjen e tij. Lëvizja Vetëvendosje dhe kryeministri Kurti sa ishin në opozitë i kanë kritikuar zëshëm rivalët e tyre pikërisht për mungesë të transparencës në dialog, por tani e injorojnë plotësisht opinionin publik, madje edhe duke pohuar 'pa frikë' se plani ekziston, por se nuk do ta bëjnë publik. Ky injorim, këto bisedime të fshehta, kjo mungesë e 'frikës'

nga opinionin publik, të gjitha këto e bëjnë të frikshme mungesën e transparencës në dialog", thuhet në komunikatën e LB-së.

LB-ja konsideron se kryeministri Kurti duhet ta njoftojë opinionin publik për kornizën e ofruar të marrëveshjes. "Ai dhe Qeveria e Kosovës duhet ta shfrytëzojnë këtë moment që, duke e vendosur në qendër parimin e reciprocitetit, të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme edhe për Kosovën Lindore dhe për veriun e Kosovës. Përndryshe, me këtë qasje të qeverisë, ku njëherë e trajtonte dialogun si prioritet të shtatë a të tetë, e tani e ka prioritet të parë, por duke e mbajtur në fshehtësi procesin, mund të jemi dëshmitarë të marrëveshjeve të cilat nuk i zgjidhin problemet themelore në mes të dy vendeve, duke i shtyrë ato dhe, si pasojë, duke vazhduar ta mbajnë Kosovën në një gjendje të pafavorshme status quo-je", është theksuar në komunikatën e LB-së. Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

(KMDLNj) ka vlerësuar se bisedimet me Serbinë po vazhdojnë në një terr thuaja të plotë informativ. "Qytetarët e Kosovës, si fitues të zgjedhjeve të fundit, që ia dhanë besimin mbi 50 për qind koalicionit që aktualisht ka pushtet absolut, kanë pritur se do të ketë transparencë më të madhe sidomos për ecurinë e këtyre bisedimeve. Kohën e fundit në opinion po qarkullojnë disa modele për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë për normalizim të marrëdhënieve, ndërsa mbizotërues është propozimi francez-gjerman që preferon modelin e dy gjermanive", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Në lidhje me këtë proces të dialogut, KMDLNj ka komentuar edhe vizitat e shpeshta të emisarëve të këtyre shteteve në Prishtinë. "Ka filluar presioni i ndërkombëtarëve që të pranohet ky propozim sepse ai i radhës mund të jetë më i keq. Shantazh dhe presion klasik dhe, në këtë luftë të pandershme, po shquhet eurodeputetja Viola von Kramon dhe ca të tjerë. Për habi, opozita nuk po insiston që të sigurohet kjo transparencë për bisedime, ndonëse e ka detyrim ndaj votuesve", theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

Tutje thuhet se opozita, duke luajtur rol pasiv, është duke marrë pjesë në mjegullimin e procesit të bisedimeve, në ndërkohë që, sipas KMDLNj-së, do të duhej t'i përdorte të gjitha mjetet parlamentare për ta detyruar kryeministrin e Kosovës të raportojë në baza të rregullta për këto bisedime.

Filluan punimet në rrugën "Besim Telaku" në Prizren

PRIZREN, 19 TETOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se projektet kapitale në këtë komunë po vazhdojnë konform kërkesave të qytetarëve. "Në kuadër të projektit 'Rehabilitimi dhe

ndërtimi i rrugëve me asfalt në komunën e Prizrenit', sot filluan punimet në infrastrukturën rrugore (asfaltim, kanalizim dhe ujësjellës) të rrugës 'Besim Telaku' (ish-Euromarketi - Ortakoll, Prizren). Do të punohet

në mënyrë efikase që projekti të përfundojë sa më shpejt, pasi këto projekte janë të një rëndësie të veçantë për rregullimin e infrastrukturës për banorët e zonës dhe e lehtësojnë jetën e tyre", ka njoftuar Totaj.



Aksion për fajde në Gjakovë, arrestohen pesë persona



GJAKOVË, 19 TETOR - Prokuroria Themelore në Gjakovë, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore disamujore dhe pas sigurimit të provave të nevojshme, duke zbatuar edhe masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, pas hartimit të planit operativ me DRP-Gjakovë dhe me asistimin e dy drejtorive rajonale të Policisë Prizren dhe Pejë, sipas urdhërësës së Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, është realizuar kontrolli dhe bastisja në shtëpitë dhe objektet e tjera përcjellëse ndaj shtatë të pandehurve duke përfshirë 10 lokacione të ndryshme në Gjakovë, në të cilin aksion kanë marrë pjesë rreth 90 zyrtarë policorë.

Gjatë bastisjes janë gjetur, në cilësi të provave materiale dhe sendeve të dyshuara, dhe janë

sekustruar gjashtëmbëdhjetë vetura, dy motoçikleta, pesë armë të llojeve të ndryshme, USB, telefona, dokumente, kontrata, regjistra, para dhe prova të tjera, të cilat dyshohet se janë të përfituara me kryerjen e veprës penale të fajdesë.

Pas përfundimit të aksionit janë arrestuar pesë persona nën dyshimin se kanë kryer veprën penale të "Fajdesë" nga neni 331 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa dy persona të tjerë gjenden në arrati dhe janë në kërkim policor.

Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj pesë të pandehurve në Gjykatën Themelore në Gjakovë, ku pritet që gjatë ditës të mbahet seanca dëgjimore në lidhje me kërkesën e prokurorisë.

Komuna e Podujevës nis fushatën vetëdijesuese kundër trafikimit të njerëzve

PODUJEVË, 19 TETOR - Komuna e Podujevës ka mbajtur takim për koordinimin e aktiviteteve njëmujore të fushatës vetëdijesuese kundër trafikimit të njerëzve me qëllim të parandalimit të dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit seksual apo keqpërdorimit në çfarëdo lloj forme.

Koordinatori i Njësitit për të Drejtat e Njeriut, Ahmet Ahmeti, ka thënë se trafikimi i njerëzve sot është një sfidë reale ndaj sistemit tonë dhe vlerave shoqërore, një shkelje e të drejtave themelore të njeriut dhe lirisë, dhe ne si shoqëri duhet të angazhohemi të luftojmë këtë dukuri me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit.

Gjatë takimit me theks të veçantë u diskutua për rrezikun e trafikimit të fëmijëve në shkolla,

ku mund të bien pre e ndonjë rrjeti trafikant dhe ngritja e vetëdijes është shumë e nevojshme, ku të gjithë aktorët pjesëmarrës u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në mes të zinxhirit "Shkollë, prindër, DKA dhe institucione të sigurisë". Motoja e fushatës është "Trafikimi prekë të gjithë, ta mbrojmë veten dhe fëmijët tanë". Komuna e Podujevës ka njoftuar se po punon vazhdimisht për krijimin e mekanizmave lokalë me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të trafikimit njerëzor për krijimin e një ambienti të sigurt dhe të dinjitetshëm për të gjithë.

Në kuadër të fushatës njëmujore "Trafikimi prekë të gjithë, ta mbrojmë veten dhe fëmijët tanë", do të mbahen aktivitete të ndryshme në shkolla nga Njësi i për të Drejtat e Njeriut me aktorët relevantë.



Lladrovci emëron dy drejtoresha dhe një shef kabineti

Drenas, 19 tetor - Me qëllim të ngritjes së efikasitetit e në pajtim me ligjin, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci mori vendim për

disa ndryshime në kabinetin e tij. Laureta Thaqi është emëruar drejtoreshë e Administratës, Enkela Dema është emëruar

drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa shef të kabinetit ka emëruar Skënder Berishën. Kryetari Lladrovci ka thënë se

premtimin se do të jetë komuna shembull për performancë në nivel kombëtar do të vazhdojë ta mbajë.



Sa janë reale arritjet ekonomike që i trumbeton qeveria?



PRISHTINË, 19 TETOR - Jo të gjitha arritjet në sektorin ekonomik që i përmend Qeveria e Kosovës shihen si reale dhe si rezultat i punës së saj. Një prej të arriturave të pretenduara, ku hidhen dyshime, është rritja e eksportit si rezultat i politikave qeveritare. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën janar-gusht 2022, eksporti i produkteve "Made in Kosova", apo të bëra në Kosovë, ka arritur vlerën e mbi 600 milionë eurove.

Në vitin 2019, për shembull, kjo vlerë ka qenë afër 400 milionë euro.

Sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i cili ka marrë detyrën në fund të marsit të vitit të kaluar, rritja e eksporteve është rezultat i "politikave të duhura" dhe "qeverisjes së mirë". "Me qeverinë tonë eksportet në këtë periudhë janë rritur trefish më shpejt në krahasim me vitet kur kanë udhëhequr qeveritë e kaluara", ka thënë Kurti gjatë një prezantimi më 8 tetor.

Kompania "Frutex" nga Suhareka, e cila merret me prodhimin e pijeve joalkoolike dhe energjike, është prej atyre që kanë shënuar rritje në eksport.

Pronari Shaqir Palushi thotë se rritja ka qenë mbi 20 për qind këtë vit krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, ai ia atribuon suksesin, siç thotë, angazhimit që është bërë brenda kompanisë. Nga qeveria, përkatësisht Ministria e Tregtisë, thotë se është ndihmuar për pjesëmarrje në

panairët ndërkombëtare por kjo, sipas tij, nuk është e mjaftueshme. "Për të ndihmuar në rritjen e eksportit, qeveria duhet ta subvencionojë pjesën e tatimit në fitim për vlerën e eksportuar. Kjo do të na ndihmonte që të jemi edhe konkurrentë në tregun e jashtëm", thotë Palushi për "Radion Evropa e Lirë".

Kosova eksporton më së shumti mallra të përpunuara dhe destinacionet e saj kryesore janë vendet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian. Së voni ka pasur rritje të konsiderueshme të eksportit edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sipas të dhënave të ASK-së, eksporti i Kosovës në ShBA ka arritur në mbi 120 milionë euro në vitin 2021, nga 2.3 milionë euro sa ka qenë në vitin 2019.

Sipas Odës Ekonomike Amerikane në Prishtinë, kjo ka ndodhur pasi eksportuesit nga Kosova kanë nisur ta shfrytëzojnë të ashtuquajturin Sistem i Përgjithësuar i Preferencave (GSP).

Ky sistem, pjesë e të cilit Kosova është që nga viti 2012, mundëson eksportimin e mbi 3 000 produkteve nga Kosova pa iu nënshtruar detyrimeve doganore në ShBA.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, thotë se qeveria nuk mund të thotë se ka ndërmarrë ndonjë masë apo politikë të caktuar që ka ndikuar në performancën e eksportit.

"Suksesi për rritje të eksportit u takon kompanive private dhe

performancës së tyre", ka shkruar Rukiqi në "Facebook" më 8 tetor.

Kurti: Pesëmbëdhjetë mijë vende të reja pune

Për kryeministrin Kurti, një arritje tjetër e qeverisë së tij është rritja e punësimit. Sipas tij, nga janari deri në gusht të këtij viti janë hapur mbi 15 mijë vende të reja pune. Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), dërguar "Radios Evropa e Lirë" flasin, po ashtu, për rritje. Sipas tyre, numri i të punësuarve në Kosovë në periudhën janar-korrik të vitit 2022 ka qenë 387 565, krahasuar me 369 540 në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Pothuajse të njëjtat të dhëna për numrin e kontributpaguesve jepen edhe nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Por, sipas përfaqësuesve të Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, shtim të numrit të punëtorëve në Kosovë nuk ka pasur. "Ata punëtorë që thuhet se janë punësuar këtë vit, kanë qenë duke punuar... vetëm se kompanitë i kanë regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës. Janë formalizuar për shkak të subvencioneve që kompanitë kanë marrë nga shteti", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat.

Qeveria e Kosovës, vitin e kaluar, ka miratuar një pako prej 420 milionë eurosh për, siç është thënë, rimëkëmbje ekonomike,

pas pasojave që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit.

Nga kjo pako qeveria ka ndarë disa herë mjete për t'i subvencionuar bizneset.

Në gushtin e kaluar ajo ka ndarë 150 milionë euro për rikthimin në punë të disa punëtorëve që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Përmes ndihmës për bizneset, synimi i qeverisë ka qenë edhe ta rrisë formalizimin e punëtorëve. Për këtë qëllim edhe Administrata Tatimore e Kosovës vitin e kaluar ka nisur projektin e ashtuquajtur "Punësimi joformal 2021-2022". Në kuadër të tij, ATK-ja ka kryer disa aktivitete për identifikimin e personave që nuk i përmbushin detyrimet për regjistrimin e punëtorëve.

Parashikimet për rritje ekonomike

Nxitur kryesisht nga eksportet dhe investimet, Qeveria e Kosovës ka parashikuar rritje ekonomike për vitin 2022 nga 4.5 deri në 5.7 për qind. Sipas një deklarate të mëhershme të ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, Hekuran Murati, rritja reale ekonomike do të arrijë në 5.7 për qind këtë vit.

Ky parashikim është më i lartë se ai i mekanizmave financiarë ndërkombëtarë.

Në një raport të publikuar më 4 tetor, Banka Botërore ka parashikuar rritje ekonomike për Kosovën deri në 3.01 për qind.

Në vitin 2021 rritja ekonomike në Kosovë ka qenë 10 për qind,

krahasuar me 5.3 për qind në vitin 2020.

ATK bën të ditur për Radion Evropa e Lirë se numri i punëtorëve të formalizuar në këtë periudhë - që do të thotë se paguajnë kontribute dhe tatime - ka arritur në 4 413. Megjithatë, dinamikat pozitive që kanë karakterizuar edhe ekonominë globale në vitin 2021, pas përmirësimit të gjendjes pandemike dhe rihapjes së ekonomive, janë përmbysur në muajt e parë të vitit 2022, kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës.

Lufta mes dy vendeve - të dyja ndër eksportueset kryesore të drithërave dhe produkteve të tjera - ka shkaktuar çrregullime të mëdha në tregje dhe rritje të inflacionit.

Në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave, inflacioni në muajin shtator ka arritur në 12.7 për qind krahasuar me 0.2 për qind sa ka qenë në shtator të vitit të kaluar. Sipas raportit të Bankës Botërore, presioni nga rritja e inflacionit pritet ta ulë fuqinë blerëse dhe ta ngadalësojë rritjen e konsumit privat.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), në një raport të publikuar në gusht, ka vlerësuar se lufta në Ukrainë, përveçse ka ndërprerë trendin e rritjes ekonomike, ka rritur konsiderueshëm rreziqet e përgjithshme ndaj stabilitetit financiar. Sipas BQK-së, shkalla e lartë e inflacionit është duke ndikuar në rënien e fuqisë blerëse të familjeve, me theks të veçantë të atyre me të ardhura më të ulëta.

Abdixhiku: Çfarë është blerë me 100 euro vitin e kaluar, sot blihet me 150 euro



PRISHTINË, 19 TETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se çfarë është blerë në fillimvitin e kaluar me 100 euro, po blihet tash me 150 euro. Ai në "Facebook" ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta largojë Tatimin në Vlerë të Shtuar (TVSh) për produktet e shportës familjare. "Çmimi i

miellit, vajit, bukës, qumështit, vezëve, domateve, patateve, orizit, fasuleve, sheqerit, naftës, benzinës e energjisë elektrike është rritur për 50 % në njëzet muajt e fundit. Çfarë është blerë me 100 euro në fillim të vitit të shkuar, duhet të blihet me 150 euro sot. Këto nuk janë produkte luksi e as të zëvendësueshme s'janë. Janë

pjesë thelbësore e shpenzimeve mujore për çdo familje në vend. Heqja e TVSh-së vetëm për këto produkte elementare s'e dëmton buxhetin e vendit. Heqja e TVSh-së lehtëson dukshëm përballueshmërinë e kosovarëve në këtë krizë të paprecedentë. Ky është propozimi ynë nga marsi i këtij viti", ka thënë Abdixhiku.

AAK-ja ka tri propozime për krizën energjetike në vend

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 TETOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë veprime të guximshme dhe të sakta sa i përket krizës energjetike në vend.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie ka thënë se situata e energjisë në vend është e jashtëzakonshme. "Jo vetëm në Kosovë, po gjithandej ekziston një krizë serioze në raport me energjinë. Duke ditur se kapacitetet e energjisë, pesë blloqet e Kosovës A dhe dy blloqet e Kosovës B janë në gjendje të rëndë si në raport me remontet ashtu edhe me prodhim, AAK-ja propozon qëndrime që janë jetike dhe urgjente", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se AAK-ja e konsideron jetike fokusin e politikave të shtetit në investimet në strategji, ku prioriteti numër një duhet të jetë investimet e shtetit në sektorin e energjisë. "Përmirësimi i gjendjes në sektorin e energjisë mund të ndodhë me tri vendime të sakta, të guximshme dhe të drejtpërdrejta në investime në sektorin e energjisë. E para, dhe më urgjentja, lidhet me nisjen e procedurave të shtetit të Kosovës në investime në energji me linjit, të fillojnë ndërtimet e kapaciteteve të reja, ndërtimi i një termocentrali të ri që do t'i zëvendësonte termocentralet e vjetra. E dyta, duhet të stimulohet dhe subvencionohet energjia alternative, ajo me erë,

solarja dhe hidrocentralet e vogla për të cilat duhet të kemi analizë të saktë ku nuk dëmtohet natyra dhe ambienti i Kosovës. E treta, gazsjellësi amerikan, i cili siguron burimin e gazit amerikan dhe lidhjen e qëndrueshme të Kosovës me rrjetin evropian dhe vendet e rajonit që e kanë bërë këtë lidhje", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se AAK-ja nga sot ka nisur procesin e konsultimit publik me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë se pse Kosova duhet të ketë investime në energji në vendin më të pasur me linjit.

Ndërkaq deputeti Pal Lekaj ka folur për marrëveshjen Kosovë - Serbi sa i përket energjisë në veri të vendit, ku kompania serbe "Elektroserver" nuk i ka plotësuar kushtet që i përcakton Udhërrëfyesi për Marrëveshjen për Energji. Lekaj ka thënë se obligimet që i ka pasur "Elektroserveri" sa i përket licencës që e ka marrë është dashur t'i nënshkruajë marrëveshjet e domosdoshme teknike për të operuar në tregun e Kosovës siç është marrëveshja kornizë për aderim në rregullat e tregut, marrëveshja për detyrime të balancimit me KOSTT-in dhe marrëveshjen komerciale me KEDS-in. Lidhur me këtë marrëveshje ka ngecje dhe ende nuk ka përfunduar. "Po ashtu, KOSTT dhe KEDS nuk kanë qasje në veri. Ne e kemi përkrahur këtë marrëveshje, sepse i ka kushtuar mjaft humbje buxhetit të Kosovës, e deri në përfundim të këtij viti pothuajse do të paguhen 100 milionë euro për qytetarët që fare nuk paguajnë



energji e që është diskriminim për qytetarët e tjerë që paguajnë", ka thënë Lekaj.

Ai ka shtuar se si AAK i kanë përkrahur tri vendime për shpallje të emergjencës në energji duke menduar se kjo është do të përfundojë e të mos i kushtojë kaq shumë buxhetit të shtetit të Kosovës.

"Në pajtim me pikën 8 të udhërrëfyesit kërkohet një mendim nga BE-ja që deri kur dhe pse ka ngecur kjo marrëveshje, dhe a mund të tërhiqet licenca", ka thënë Lekaj. "Elektroserver"-i është licencuar më 24 qershor nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), për furnizimin

me rrymë të qytetarëve të katër komunave të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, si dhe për faturimin e tyre. "Elektroserver" i ka pasur afat 100 ditë për plotësimin e kushteve që do t'i mundësonin operimin në tregun e Kosovës. Nga data e licencimit kanë kaluar 116 ditë.

Sindikatat kritikojnë Projektligjin për Pagat

PRISHTINË, 19 TETOR - Përfaqësues të sindikatave kanë kritikuar Projektligjin për Pagat, atë për Shërbyesit Civilë dhe për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK). Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atthe Hykolli,

ka thënë se janë duke i përcjellë këto tri projektligje. "Ne si BSPK jemi duke i përcjellë me vëmendje këto ligje, që e ndërtojnë sistemin e punës", ka deklaruar Hykolli. Ndërsa Ali Sefaj ka theksuar se me anë të këtyre ligjeve po avancohet vetëm personeli politik, derisa po

diskriminohen shërbyesit civilë. "Këto tri ligje determinojnë statusin tonë juridik, mirëqenien tonë financiare dhe veçmas nëse këto ligje janë të mira e të duhura do të bëjnë që të kemi reforma të mirëfillta në administratën shtetërore", ka thënë Sefaj.



Gazi, borxhet dhe marrëveshjet e vështira: Tre “fytyrat” e krizës evropiane



Nga Lucrezia REICHLIN
“Corriere Della Sera”

Sapo përfundoi në Uashington takimi vjeshtor i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, ku tradicionalisht morën pjesë bankierë qendrorë dhe të nivelit të dytë, Ministra të Financave, politikanë dhe akademikë. Aktiviteti u dominua nga një pesimizëm i madh, i përforcuar nga rishikimet me prioritet në rënie të parashikimeve të FMN-së për rritjen e ekonomisë globale. Siç është diskutuar shpeshherë në media, FMN pret një rritje ekonomike negative për Italinë për vitin 2023 (-0.2 për qind), e cila është në kontrast me +0.7 për qind që parashikon qeveria në largim e Mario Draghi. Profesionistët e fushës e dinë se parashikimi i PBB-së për të 2 tremujorëve është shumë i vështirë, dhe vlerësimet rishikohen vazhdimisht. Në një hapësirë kohore 1-vjeçare, shifrat varen mbi të gjitha nga një vlerësim cilësor i rrezikut. Dhe duhet të mendojmë për vlerësimin e këtij të fundit. Rreziku i parë është zgjatja e krizës energjetike, që nga ana tjetër lidhet me krizën gjeopolitike. Ideja për të shkuar drejt një normalizimi të afërt, po duket gjithnjë e më e pamundur. Për Evropën, një importuese e madhe, kjo përbën një goditje negative e cila do të rëndojë mbi aktivitetin ekonomik në vitet në

vijim. Rreziku i dytë buron nga vazhdimësia e inflacionit përtej pritshmërive, gjë që i ka nxitur bankat qendrore të përshpejtojnë masat e politikave monetare shtërnguese. Masat monetare shtërnguese janë të sinkronizuara në nivel global (në fakt përfshijnë të gjitha vendet me përjashtim të Kinës dhe Turqisë), ndaj ka një ndikim të rëndë tek kushtet e financimit të kompanive dhe familjeve. Megjithatë inflacioni në Evropë është i nxitur kryesisht nga energjia, dhe është më pak i përgjithësuar se në Shtetet e Bashkuara, BQE nuk mund të devijojë shumë nga politika monetare e SHBA-së, pasi kjo do të çonte në një zhvlerësim të mëtejshëm të euros përkundër dollarit, me forcimin e mëtejshëm të shtytjes inflacioniste në eurozonë. Ndaj, ajo që do të ndodhë vitin e ardhshëm varet nga mënyra se si do të evoluojë situata në tre frontet: energjia, inflacioni dhe kushtet e financimit. Nga ana tjetër, kjo e fundit do të varet nga aftësia e qeverive kombëtare dhe BE-së për të reaguar siç duhet. Por që të ndodhë kjo gjë, përgjigja do të duhet të udhëhiqet nga tre vetëdije. Së pari, problemi i energjisë është në qendër të kësaj krize, dhe ai kërkon një përgjigje largpamës bazuar tek një strategji afatgjatë. Ky problem nuk do të zgjidhet deri në vitin 2023. Së dyti, politikat e shpenzimeve të financuara nga borxhi duhet të

kalibrohen me kujdes, pasi ato mund të shtërngojnë kushtet e financimit siç ndodhi në Britaninë e Madhe, dhe për këtë arsye të dëmtojmë çdo lloj hapësire për manovrim. Së treti, është i nevojshëm një reagim në nivel evropian për arsye të ndryshme: për të arritur një efikasitet më të madh dhe kapacitet kontraktual për blerjen e lëndëve të para, racionimin dhe ruajtjen e tyre; ruajtjen e tregut të përbashkët dhe shmangien e konkurrencës ndërmjet vendeve; financimin e politikave që synojnë objektivat e përbashkëta, dhe në veçanti favorizimin e tranzicionit drejt burimeve të rinovueshme. Veprimi në këtë bazë vështirësohet nga urgjenca që shtyn drejt zgjidhjeve që shpesh janë në kontrast me objektivat afatgjatë dhe vështirësinë e dukshme për të gjetur një marrëveshje në Evropë për politikat e përbashkëta. Për krizën aktuale, Italia shpenzoi 60 miliardë euro, më shumë se Franca dhe Gjermania. Ajo ishte në gjendje ta bënte këtë falë të dhënave mjaft pozitive të financave publike, të nxitura nga rritja ekonomike shumë e fortë gjatë viteve 2021-2022. Por me ngadalësimin ekonomik dhe inflacionin që reflekton sot norma më të larta të interesit, hapësira për manovrim është reduktuar ndjeshëm. Kjo e vështirëson zbatimin e masave të reja të financuara nga borxhi. Prandaj ne duhet të angazhohemi

fort për përdorimin eficient të energjisë, dhe të pranojmë shkurtime në konsumin e gazit, që në Itali nuk ka rënë në gjashtë muajt e parë të 2022. Masat që merren për emergjencën duhet të jetë në përputhje me objektivat afatgjatë që synojnë dekurajimin e përdorimit të energjisë fosile. Nga ky këndvështrim, zgjidhja nuk është vendosja e një tavani mbi çmimin e gazit. Tani le të ndalemi tek negociatat evropiane. Çdo kryeqytet evropian e ka parasysh nevojën për të krijuar një strategji të përbashkët për të përballuar krizën, por është e vështirë të arrihet në një konsensus, sepse vendet e ndryshme kanë dobësi të ndryshme, dhe për rrjedhojë interesa të ndryshme. Për shembull, Gjermania ka një sistem produktiv me energji intensive si i yni, por nuk ka mundësi që të diversifikojë burimet e furnizimit. Nga këtu buron edhe hezitimi për të pranuar masat që mund të çojnë në një rënie të papritur të furnizimit me gaz. Negociatat duhet të zhvillohen duke pasur parasysh këtë vetëdije. Demonizimi i Gjermanisë që ka ndarë (nuk ka shpenzuar) 200 miliardë euro në një fond të posaçëm kushtuar të gjitha disbursemeve që lidhen me krizën energjetike për 2 vitet e ardhshme (dhe jo vetëm subvencione) nuk është shumë i dobishëm dhe as i drejtë. Është më e dobishme të përpiqemi të pajisemi me mjetet operative dhe ligjore për të operuar në treg si

një agjent i vetëm. Madje, kërkesa për një fond financiar përmes borxhit të përbashkët sipas modelit të atij që u krijua për përbashkëtimin e pasojave të Covid-19, është më e preferuara për vendet me nivelin më të lartë të borxhit si Italia, por nuk duket e sigurt se do të plotësohet. Për t'i dhënë forcë projektit, ai duhet të motivohet si një mjet për të ndjekur objektivat strategjike në fushën e energjisë, kryesisht për tranzicionin drejt ekonomisë miqësore me mjedisin. Një fond i përbashkët i përdorur për të financuar politika të ndryshme kombëtare, dhe për të kundërshtuar njëra-tjetrën mund të jetë kundër-produktiv. Ky negociim është një test për të kuptuar nëse Evropa do të jetë në gjendje të gjejë kompromisin e nevojshëm për të ecur drejt një politike reale të përbashkët energjetike, duke kryer reformat e nevojshme, dhe duke e forcuar angazhimin e saj ndaj objektivave të ekonomisë së gjelbër. Nëse do t'ia dalë, ky do të jetë një hap tjetër drejt një integriteti më të madh brenda unionit. Nëse dështon, Italia dhe çdo shtet tjetër i BE-së, do të pësojnë një humbje të konkurrencës dhe do të duhet të përballen me një çënueshmëri më të madhe ndaj sigurisë energjetike. Është një lojë që luhet sot, por që sheh nga e ardhmja, dhe rezultati i së cilës do të ketë pasojë për vendin tonë për dekadat e ardhshme.

A mund të përballet SHBA njëkohësisht me Kinën, Iranin dhe Rusinë?



Nga Hal BRANDS
"Bloomberg"

Imagjinoni një skenar në të cilin, për 1 ose 2 vite nga tani, bota tronditet nga një luftë e madhe që shtrihet nga Evropa në Paqësor. Kjo ide nuk është edhe aq absurde sa mund të mendoni. Për dekada me radhë SHBA-ja nuk është përballet me perspektivën e një përplasjeje ushtarake në disa fronte njëherësh.

Pushtimi i Ukrainës nga presidenti rus Vladimir Putin, ka shkaktuar konfliktin më të madh të Evropës ndër breza, dhe ka provokuar një luftë të tërthortë midis fuqive të mëdha. Në Azinë Lindore po rriten shanset për luftë, dhe këtë e treguan tensionet e nxitura nga vizita në gusht në Tajvan e kryetares së Kongresit Amerikan Nancy Pelosi.

Në Lindjen e Mesme, SHBA-së mund t'i detyrohet të zgjedhë midis luftës kundër Iranit dhe pranimit të tij si një shtet me armë bërthamore. Nëse i mblidhni këto kriza së bashku, atëherë do të kemi një situatë të paprecedentë në dekadat e fundit.

Natyrish, zakonisht skenarët e makthit nuk përmbushen vërtet. Ka të ngjarë që asnjë nga këto situata të mos e tërheqë SHBA-në në luftë, dhe afatet kohore më të besueshme drejt konfliktit ndryshojnë sipas rajonit. Por mendimi serioz për to, tregon se sa i madh është bërë rreziku i një lufte të madhe.

Dhe kjo na kujton se krizat e sotme janë më shumë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, nga sa duken në plan të parë. Kundërshtarët e Amerikës mund të mos jenë zyrtarisht aleatë, por ata janë të rreshtuar në një zonë shumë të rëndësishme, në zemër të Euroazisë.

Një SHBA që shpërndan energjitë sa andej-këtej nuk mund të reagojë ndaj një problemi pa analizuar më parë ndikimin në aftësinë e saj për t'u marrë me të tjerët. Në disa aspekte, gjendja e vështirë ku ndodhet sot Amerika i ngjan periudhës para Luftës së Dytë Botërore.

Si atëherë, ashtu edhe tani, sistemi ndërkombëtar po goditet nga shumë drejtime. Japonia kërkonte dominimin në Lindjen e Largët. Gjermania e Hitlerit synonte dominimin në Evropë dhe madje përtej saj. Italia e Musolinit po kërkonte të krijonte një perandori në Mesdhe dhe Afrikë.

Bashkimi Sovjetik do ta luftonte Hitlerin, por vetëm pasi e ndihmonte atë të gllabëronte Evropën Lindore. Midis atyre shteteve revizioniste kishte pak afërsi. Ideologjitë e ndryshme raciste që motivuan Gjermaninë naziste dhe Japoninë Perandorake ishin në thelb të papajtueshme midis tyre.

Edhe pse Berlini, Roma dhe Tokio nënshkruan Paktin e tyre Trepalësh në vitin 1940, mosbesimi i fortë bëri që ajo të ishte pak më shumë se një marrëveshje për të hedhur në erë rendin ekzistues dhe për të ndërtuar perandori të veçanta në mesin e rrenojave.

Gjithsesi diktatorët e mbështetën njëri-tjetrin në momente kritike. Mbështetja e Musolinit e ndihmoi Hitlerin për pushtimin pa gjakderdhje të Austrisë dhe Sudeteve në vitin 1938. Sulmi i gjerë i Gjermanisë ndaj Evropës Perëndimore në vitin 1940, e motivoi Japoninë të pushtonte zona të gjera të Azisë Juglindore dhe Paqësorit.

Situata në Evropën Lindore është shumë e tensionuar për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Putini,

në kuadër të një fushate për të rivendosur epërsinë ruse nga Azia Qendrore në Detin Baltik. Një sulm-rrufe i suksesshëm në shkurt mund t'i kishte dhënë Rusisë një pozitë dominuese në Evropën Lindore, duke e shtuar presionin ndaj NATO-s.

Por gabimet e rënda të rusëve dhe rezistenca e ukrainasve e shmangën këtë skenar. Por edhe një Rusi e dobësuar ushtarakisht do të ketë ende shumë aftësi për të krijuar telashe, dhe konflikti i Ukrainës është larg fundit. Si Ukraina po ashtu edhe Rusia kanë synime ambicioze. Kiev i kërkon çlirimin e të gjithë territorit të pushtuar, përfshirë Krimenë. Ndërsa Moska synon ta kthejë Ukrainën në një shtet vasal të varfëruar. Ndërkohë, mund të ketë nisur numërimi mbrapsht për luftën në Ngushticën e Tajvanit.

Pekini e përdori vizitën e Pelosit në Tajvan si pretekst për nisjen e disa stërvitjeve ushtarake agresive.

Me siguri që zyrtarët kinezë preferojnë të arrijnë qëllimet e tyre – kontrollin e Tajvanit dhe dëbimin SHBA-së nga Paqësori Perëndimor – pa ndonjë luftë të madhe. Ka gjasa që kaosi i ushtrisë së Putinit në Ukrainë e ka bërë presidentin kinez Xi Jinping më të kujdesshëm për përdorimin e forcës.

Por forcimi i ushtrisë kineze në 3 dekadat e fundit i jep Xi-së një mundësi shumë më të mirë për ta nënshtruar Tajvanin me forcë, nëse do të dëshirojë ta bëjë këtë gjë. Dhe ai mund të detyrohet të përdorë forcën për të marrë atë që dëshiron. Shanset që Taipei t'i nënshtrohet paqësisht një Kine neo-totalitare zvogëlohen çdo vit që kalon.

Ndërsa SHBA dhe aleatët e saj, duken gjithnjë e më të vendosur për të penguar synimin e Pekinit

për dominim rajonal. Pastaj është Lindja e Mesme, një rajon vazhdimisht nën tensione të mëdha, të cilin amerikanët do të donin ta injoronin. Lufta midis Uashingtonit dhe Teheranit ishte gati të niste gjatë vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, pas shtimit të tensioneve që nisën me tërheqjen e SHBA-së nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015, dhe që kulmuan me vrasjen e gjeneralit Qassem Soleimani në një sulm me dron.

Thuhet se përparimet e Iranit në pasurimin e uranimit i kanë dhënë atij aftësinë për të prodhuar një armë bërthamore brenda një kohe të shkurtër. Prandaj, SHBA dhe Izraeli duhet të shqyrtojnë nëse nevojiten më shumë metoda shtrënguese për ta penguar Iranin ta kalojë këtë vijë të kuqe.

Një krizë e fortë mund të shpërthejë shumë shpejt nëse dështojnë negociatat për të ringjallur marrëveshjen bërthamore të 7 viteve më parë. Lufta midis SHBA-së dhe rivalëve të saj nuk është e pashmangshme në asnjë nga këto zona. Tensionet e mëdha me Kinën dhe Rusinë e detyrojnë Uashingtonin të sillt me shumë kujdes ndaj Iranit.

Po ashtu, administrata Biden duhet të jetë e kujdesshme për të mos e provokuar Xi-në, në një kohë që po përballet fort në Ukrainë me Putinin. Sigurisht, rivalët e Amerikës janë miq me shumë pikëpyetje ndaj njëri-tjetrit. Xi nuk e shpëtoi Putinin nga "moçali" e tij në Ukrainë.

Nëse Kina, Rusia dhe Irani do ta dëbonin SHBA-në nga Euroazia, ata mund të përplasen me njëri-tjetrin. Pasi asnjëri nuk mund t'i arrijë qëllimet e tij pa u përballet me sukses me një superfuqi, e cila u jep atyre një motivim të jashtëzakonshme për të


bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Mos prisni që Rusia, Irani dhe Kina të kryejnë vetëvrasje për njëri-tjetrin, por mos mendoni se do të jenë indiferentë ndaj fatit të njëri-tjetrit. Shpeshherë qeveria e SHBA-së e ka të vështirë të menaxhojë më shumë se një krizë në të njëjtën kohë, pasi vëmendja e politikë-bërësve kryesorë është e kufizuar.

Për më tepër, Amerika ka aktualisht më pak aftësi për t'u përballet me sfida të shumta ushtarake sesa në çdo periudhë tjetër që nga Lufta e Ftohtë. Reduktimet e rëndësishme për sektorin e mbrojtjes në fillim të viteve 2010, të kombinuara me një mjedis kërcënues në përqendrim, e detyruan SHBA-në të miratonte një strategji të mbrojtjes për "një luftë", në vend të standardit të dy luftërave, siç përcaktohet nga dokumentet strategjike të viteve 1990 dhe 2000.

Pra kjo do të thotë se Pentagonit i mungojnë mjetet për t'u angazhuar në 2 ose më shumë luftëra njëkohësisht. Siç ka treguar lufta e Ukrainës dhe një grup analizash jopartiake, SHBA-së i duhet dëshpërimisht një rritje në shpenzimet e mbrojtjes për të vënë në dispozicion aftësitë, për të rritur rezervat e municioneve, dhe për të forcur bazën industriale të nevojshme për të fituar një luftë, për të mos folur për 2 apo 3 të tilla që ndodhin në të njëjtën kohë.

Marrë me shkurtime

Shënim: Hal Brands, profesor në Shkollën e Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare të Universitetit Xhon Hopkins, dhe anëtar i Bordit të Politikës së Jashtme të Departamentit Amerikan të Shtetit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Enveri PILKINGTON
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Milani synon Brojën dhe Ziyechin, por mund ta humbet Bennacerin

MILAN, 19 TETOR - Liverpooli mund t'ia rrëmbejë Milanit mesfushorin Ismaël Bennacer, derisa janë duke negociuar transferimin e Hakim Ziyechit dhe sulmuesit shqiptar Armando Broja. Drejtorët e Milanit nuk janë

takuar vetëm me përfaqësues të Hakim Ziyech, por kanë zhvilluar negociata edhe me përfaqësues të sulmuesit shqiptar Armando Broja. Ylli shqiptar i Chelseas, Broja, pëlqehet shumë nga krerët e Milanit dhe shihet si opsion i mirë për repartin e sulmit.

Megjithatë, shqetësim mbetet edhe mesfusha. Milani ka biseduar pak edhe me Ismaël Bennacer, për të cilin ka interesim nga skuadra e Liverpoolit. Bennaceri ka kontratë deri në vitin 2024, por agjenti i tij është duke diskutuar një

ofertë prej 3 milionësh për vit. Aktualisht mesfushori algerian fiton vetëm 1.7 milion euro për sezon dhe s'është i interesuar të rinovojë. Ai do të dëgjojë oferta nga jashtë, kryesisht nga La Liga dhe Premierë Liga.



Prishtina mposht Dritën, Malisheva Ferizajn

Gjilan, 19 tetor (ER) - FC Prishtina e ka regjistruar një fitore të madhe të mërkurën si mysafire në Gjilan. "Bardhekaltrit" e kanë mposhtur Dritën me rezultat 2:1 në derbin e xhiros së 12-të të "Albi Mall Superligës" së futbollit. Gjilanasit kanë avancuar të parët falë golit të Princ Baldes, duke shënuar në minutën e 84-t të ndeshjes. Por, skuadra e Ismet Munishit ka bërë një përmbysje të pabesueshme në minutat shtesë. Fillimisht, rezultatit e ka barazuar Shefit Shefiti në minutën 91, kurse golin e fitores për Prishtinën e ka realizuar

Leutrim Kryeziu nga penalltia në minutën 93. Me këtë fitore Prishtina ia ka shkaktuar Dritës humbjen e parë sezonale. Fitore ka shënuar edhe Malisheva si mysafire e Ferizajt, duke shënuar gjashtë gola. Golat për Malishevën i kanë shënuar Bleart Tolaj, Ilir Mustafa, Agron Xhaka, Ronald Sobowale (dy gola) dhe Fiton Hajdari. Me këto rezultate, Drita ruan vendin e parë me 27 pikë, Prishtina në vendin e tretë me 18 pikë, Malisheva në vendin e shtatë me 11 pikë dhe Ferizaj në vendin e fundit me 8 pikë.



Presidenti i FIFA-s uron presidentin e FFK-së për ditëlindje

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, nëpërmjet një telegrami e ka uruar presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, me rastin e ditëlindjes së tij të 61-të. I pari i futbollit botëror, krahas urimeve, i ka shprehur mirënjohje kreut të FFK-së për mbështetjen dhe bashkëpunimin që turneu final i Kupës së Botës "Katar 2022" të jetë një ngjarje e suksesshme dhe unike. "Urime për ditëlindjen tuaj të 61-të! Uroj që kjo ditë e veçantë t'ju sjellë lumturi, shëndet dhe suksese si në aspektin personal, po ashtu edhe

në atë profesional. Në këtë vit të Kupës së Botës së FIFA-s, jam shumë mirënjohës për mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj për ta bërë këtë turne një ngjarje kaq të suksesshme dhe unike, duke mbartur një mesazh shprese, uniteti dhe solidariteti. Ju uroj një ditë të mrekullueshme me të dashurit tuaj dhe singërisht shpresoj se do të vazhdojmë të punojmë së bashku për zhvillimin dhe rritjen e kësaj loje të bukur që na bashkon të gjithëve. Mezi pres t'ju shoh sërish dhe t'ju përgëzoj personalisht", është thënë në telegramurimin e Infantinos.

"RMCsport": Mbappe s'ka kërkuar kurrë të largohet nga PSG-ja

PARIS, 19 TETOR - Kylian Mbappe vazhdon të jetë një ndër temat më të diskutuara në botën e futbollit. Ylli francez është duke përfunduar shumë për një largim

nga Paris Saint Germain (PSG), madje qysh në janar. Siç njoftojnë mediet franceze, lojtari është me valixhe në duar, pasi raportet se drejtuesit nuk i

kanë dalë në fjalë. Gjithsesi, për ta përshtjelluar edhe më shumë këtë situatë, është përkujdesur "RMCsport", sipas së cilës, Mbappe nuk ka kërkuar

asnjëherë largim nga "Parc de Princes". Mbetet të shihet se si do të përfundojë në fund kjo "sagë" që ka nisur javë më parë.





Në bazë të Nenit 17 dhe 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nr.32/15 qershor 2008, respektivisht Nenit 13 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Nr.13/30 maj 2012, të Statutit të Ndërmarrjes me protokoll Nr.817 dt. 21.03.2019, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Hortikultura" SH.A., në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë 19.10.2022, shpall:

KONKURS

I. Titulli: Kryeshef/e Ekzekutiv/e të Ndërmarrjes Publike Lokale "Hortikultura" SH.A., Prishtinë.

1. Nr. References:

2. Mbikëqyrësi: Bordi i Drejtorëve të NPL "Hortikultura" SH.A.

3. Niveli i Pagës:

4. Orari i punës: 40 orë në javë.

5. Kohëzgjatja e mandatit: Me kohë të caktuar 3 (tre) vite, me mundësi Vazhdimi/Rizgjedhje.

6. Vendi i punës: Ndërmarrja Publike Lokale "Hortikultura" SH.A, Prishtinë, Rr."Tahir Zajmi", Prishtinë.

7. Vendi: Prishtinë, Republika e Kosovës.

II. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Hortikultura" SHA në Prishtinë, në përputhje me dispozitat e parapara të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Planifikon, organizon dhe bën kontrollimin afarist të ndërmarrjes;
- Bashkëpunon dhe koordinon punët e ndërmarrjes së bashku me zyrtarët tjerë të ndërmarrjes;
- Koordinon punët e ndërmarrjes me qëllim të implementimit sa më të drejtë të politikave zhvillimore të caktuara nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes;
- Bashkëpunon ngushtë me bordin e drejtorëve si dhe raporton para bordit të drejtorëve për menaxhimin e kompanisë;
- Është autoritet i cili lidhë kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç atyre për të cilat janë në autoritetin e Bordit të Drejtorëve në pajtim me ligjet në fuqi;
- Përgatit për Bordin e Drejtorëve draft dokumente për miratim që parashikohen me ligj;
- Përgatit për Bordin e Drejtorëve raporte lidhur transaksionet kryesore të ndërmarrjes kurdo që i kërkohet nga bordi si dhe në mënyrë të rregullt së paku çdo tre muaj;
- Ofron për Komisionin e auditimit dhe auditorin e brendshëm të kompanisë të gjitha informatat e nevojshme dhe asistencën që kërkohet;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Propozon Bordit të Drejtorëve strukturën organizative të kompanisë, sistemin e punëtorëve dhe nivelizimin e pagave;
- Është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve;
- Në bashkëpunim me zyrtarët tjerë të ndërmarrjes harton Planin e Biznesit të ndërmarrjes dhe e propozon për aprovim tek Bordit të Drejtorëve;
- Mbikëqyrë përgatitjen dhe implementimin e Planit të Biznesit me qëllim të përmirësimit të performancës së ndërmarrjes;
- Përfaqëson ndërmarrjen në raport me palët e treta;
- Mban Bordin të informuar për të gjitha aktivitetet e Ndërmarrjes;
- Përpilon dhe implementon planin vjetor afarist dhe planet strategjike tek Bordi që do të sigurojnë arritjen e objektivave të saj;
- Raporton tek Bordi progresin e përgjithshëm në sfond të objektivave operative dhe financiare dhe inicion masa të veprimit për zbatim;
- Raporton dhe i përgjigjet drejtëpërdrejt Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes;
- Kryen dhe punë tjera të caktuara me ligj dhe me Statut të Ndërmarrjes.

III. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë, që cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrje Publike;
- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare ose ekuivalente, në fushën: juridike, shoqërore, ekonomike, financiare, bujqësisë, hortikulturës, pylltarisë, arkitekturën ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë biznesore të NP-së. Diplomën nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Kandidati/ja duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale apo (3) vite përvojë menaxheriale në përputhje me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;
- Njohuri mbi fushëveprimin e ndërmarrjeve publike;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Aftësi të larta organizative, drejtuese (leadership), formulim politikash të ndërmarrjes, menaxhim strategjik dhe pune ekipore;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit në të shkruar dhe të folur në njërin nga gjuhët zyrtare, e preferuar edhe njohja e gjuhës angleze;

IV. Informatë për procedurën e konkurrimit

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- ✓ Aplikacionin;
- ✓ CV-në;
- ✓ Letër motivimin;
- ✓ Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
- ✓ Dëshminë mbi përvojën e punës si dhe referencat e punës;
- ✓ Deklaratën nën Betim (e cila duhet të shkarkohet nw WEB ose tw merret fizikisht në selinë e ndërmarrjes)
- ✓ Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- ✓ Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- ✓ Kopjen e letërnjoftimit;
- ✓ Pasqyrën e Trustit Pensional;

V. Aplikacioni duhet të përmbaj:

- ✓ Titullin e vendit të punës;
- ✓ Dokumentacioni relevant i lartëcekur;
- ✓ Nënshkrimin;
- ✓ Deklaratën nën betim;

Aplikacionet së bashku me deklaratën nën betim, pranoen dhe dorëzohen së bashku me dokumentacionin e kompletuar në adresën: Ndërmarrja Publike Lokale "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë, Rr. "Tahir Zajmi", Prishtinë, Republika e Kosovës.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.

Vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e parapara me konkurs, do të përzgjedhen për procedurat e konkursit.

Konkursi mbetet i hapur nga 20.10.2022, deri më 03.11. 2022

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arber Zeqiraj shpall të pavlefshme diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Xheladin Deda" në Mitrovicë, në vitin 2018.

- Luljeta Shaqiri shpall të humbur diplomën e masterit, të lëshuar nga Kolegji UBT, drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomiks.

- Gjon Paluca shpall të pavlefshme diplomën shmit "11 Marsi" Prizren.

- Rejall Shope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Lorena Binaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "Vëllezërit Frashri" Pllanej.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë.

Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i



Na osnovu članova 17. i 21. Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima br. 32/15. juna 2008. godine, odnosno člana 13. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za Javna preduzeća br. 13/30. maj 2012. Statuta preduzeća sa protokolom br. 817 od. 21.03.2019, Administrativno uputstvo (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje konkursnih postupaka u javnom sektoru, Upravni odbor lokalnog javnog preduzeća „Hortikultura“ S.A., Priština, na sednici održanoj 19.10.2022., najavljuje:

KONKURS

I. Zvanje: Izvršni direktor lokalnog javnog preduzeća "Hortikultura" SH, Priština.

1. br. Reference:

2. Nadzornik: Upravni odbor NPL „Hortikultura“ SH.A.

3. Nivo plate:

4. Radno vreme: 40 sati nedeljno.

5. Mandat: Na određeno 3 (tri) godine, sa mogućnošću nastavka/reizbora.

6. Mesto rada: Lokalno javno preduzeće "Hortikultura" SH, Priština, Tahir Zajmi, Priština.

7. Mesto: Priština, Republika Kosovo.

II. Zahtevi i potrebne kvalifikacije:

Izvršni direktor lokalnog javnog preduzeća „Hortikultura“ dd u Prištini, u skladu sa odredbama Zakona br. 02/L-123 o privrednim društvima i Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- planira, organizuje i sprovodi kontrolu poslovanja preduzeća;
- saraduje i koordinira poslove preduzeća zajedno sa drugim službenicima preduzeća;
- Koordinira rad preduzeća u cilju što pravičnijeg sprovođenja razvojnih politika koje utvrđuje Upravni odbor Preduzeća;
- Blisko saraduje sa upravnim odborom i izveštava odbor direktora o upravljanju kompanijom;
- Organ je koji zaključuje ugovore u ime preduzeća, osim onih za koje su u nadležnosti odbora direktora u skladu sa zakonima na snazi;
- priprema za Upravni odbor nacрте dokumenata na usvajanje koji su predviđeni zakonom;
- Priprema za Upravni odbor izveštaje o glavnim transakcijama društva kad god to zahteva odbor, kao i redovno najmanje svaka tri meseca;
- Pruža odboru za reviziju i internom revizoru kompanije sve potrebne informacije i pomoć;
- Učestvuje na svim sednicama Upravnog odbora;
- Predlaže Upravnom odboru organizacionu strukturu preduzeća, sistem radnika i nivelaciju plata;
- Odgovoran je za sprovođenje odluka Upravnog odbora;
- U saradnji sa drugim službenicima preduzeća izrađuje poslovni plan preduzeća i predlaže ga na usvajanje Upravnom odboru;
- Nadgleda pripremu i implementaciju poslovnog plana u cilju poboljšanja učinka preduzeća;
- Zastupa preduzeće u odnosu na treća lica;
- Obavještava Odbor o svim aktivnostima Preduzeća;
- Sastavlja i sprovodi godišnji poslovni plan i strateške planove za Odbor koji će obezbediti postizanje njegovih ciljeva;
- Izveštava Odbor o opštem napretku u odnosu na operativne i finansijske ciljeve i inicira akcione mjere za implementaciju;
- Izveštava i odgovara direktno Upravnom odboru Društva;
- Obavlja i druge poslove utvrđene zakonom i Statutom preduzeća.

III. Kvalifikacije i stručna obuka

- Svi potencijalni kandidati moraju biti osobe visokog integriteta, koje ispunjavaju kvalifikacione uslove prema članu 17, kao i da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2 tačke (d), (f), (j), (k) i (l) Zakona o javnim preduzećima i da imaju potrebno stručno iskustvo i obrazovanje za obavljanje funkcije: Izvršni direktor u javnim preduzećima;
- Kandidat mora imati visoku stručnu spremu ili ekvivalent, iz oblasti: prava, društvene, ekonomske, finansijske, poljoprivrede, hortikulture, šumarstva, arhitekture ili iz druge oblasti nauke koja je u vezi sa djelatnošću NP. Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije;
- Kandidat mora imati najmanje pet (5) godina profesionalnog iskustva ili (3) rukovodećeg iskustva, u skladu sa kriterijumima definisanim Zakonom o javnim preduzećima;
- Poznavanje delokruga javnih preduzeća;

- Napredna znanja u korišćenju informacionih tehnologija i standardnih softverskih paketa;
- Visoke organizacione sposobnosti, liderstvo, formulisanje politika kompanije, strateško upravljanje i timski rad;
- Odlične veštine pismene i govorne komunikacije na jednom od službenih jezika, poželjno je i znanje engleskog jezika;

IV. Informacije o konkursnoj proceduri

Kandidati za glavnog izvršnog direktora moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Aplikacija;
- CV;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu i radne reference;
- Izjava pod zakletvom (koja se mora preuzeti na VEB ili fizički primiti u sedištu kompanije)
- Uverenje koje nije pod istragom (ne starije od šest meseci);
- uverenje o državljanstvu Republike Kosovo;
- Kopija lične karte;
- Izjava penzionog fonda;
- V. Prijava mora da sadrži:
- Naziv radnog mesta;
- Navedenu relevantnu dokumentaciju;
- Potpis;
- Izjava pod zakletvom;

Prijave uz izjavu pod zakletvom se prihvataju i dostavljaju zajedno sa popunjenom dokumentacijom na adresu: Mesno javno preduzeće „Hortikultura“ SH.A. u Prištini Sv. „Tahir Zajmi“, Priština, Republika Kosovo.

Kandidati koji konkurišu moraju tačno da unesu adresu i kontakt telefon, kao i mejl adresu.

U konkursne procedure biće izabrani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume utvrđene konkursom.

Konkurs ostaje otvoren od 20.10.2022 do 03.11. 2022



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë |
www.kuzhina.net | kuzhinagendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, N.P.L. "Kuzhina Qendrore" SH. A, shpall:

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

1. TITULLI I PUNËS: DREJTOR I ADMINISTRATËS - NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit
Puna provuese: 3 muaj
I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv
Nr. i Referencës: 01/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Menaxhon dhe është përgjegjës për departamentin e administratës, në përpilimin e planeve, krijon politikën në mënyrë që ndërmarrja të avancojë në përgatitjen e personelit, procedura administrative, teknologjisë informatike (TI), logjistikë, mirëmbajtje dhe çështjet tjera që hyjnë në kuadër të detyrave të departamentit.

Është përgjegjës për udhëheqjen e stafit në departamentin e administratës me të gjitha dokumentet e nevojshme.

Organizon, koordinon dhe menaxhon me punën e përgjithshme të departamentit, duke u bazuar në procedurat për administrim të personelit, azhuron punët në dosjet e punëtorëve, trajnime, specializime, zhvillon procedura të burimeve njerëzore, përgatitë kodin e sjelljes, kodin e etikës.

Vlerëson efektivitetin e punës dhe zbatueshmërinë konform procedurave, ligjeve dhe rregullave të brendshme në KQ

Merr pjesë dhe menaxhon komisionet vlerësuese për rekrutimin dhe punësimin e stafit civil të ndërmarrjes, kurse në koordinim me zyrën ligjore dhe atë të burimeve njerëzore harton kriteret për punësimin e tyre.

Merr pjesë në mbledhjet e stafit menaxhues, ndihmon Kryeshefin Ekzekutiv në caktimin e objektivave zhvillimore dhe në përmbushjen e tyre.

Përpilon plane mujore dhe vjetore të punëve dhe detyrave të shërbimit në kuadër të departamentit të administratës,

Këshillon, koordinon dhe bashkëpunon me KE për fushën e departamentit të administratës.

Përgatitë planet afat-mesme dhe afatgjata për departamentin e administratës.

Koordinon punën më të gjitha departamentet në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme në KQ.

Sipas procedurave ligjor përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për shërbimet që ofron departamenti i administratës dhe i procedon në departamentet tjera sipas manualit të operimit në KQ.

Është përgjegjës në vlerësimin vjetor të stafit të vet.

Merr masa disiplinore ndaj punëtorëve që kanë performancë të dobët në përmbushjen e detyrave të punës.

Aprovon të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me Burimet Njerëzore.

Përgatitë raporte pune për departamentin e administratës në arritjen e objektivave.

Për kryerje e detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Diplomë universitare në fushën e shkencave shoqërore, niveli master; studimet e Doktoratës në fushat e ngjashme, e preferueshme.

Pese (5) vite përvojë pune. Të paktën 3 vite në pozita menaxheriale; Të ketë edhe përvojë të punës në institucione të ngjashme si Kuzhina Qendrore Kuptim i shkëlqyer punës së kuzhinës .

Të demonstroj njohuri për kuzhinën, standardet e aplikueshme për këtë rol.

Të ketë njohuri të mjaftueshme të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të zakonshme për punë në Kuzhinë.

Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit.

Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.

Aftësitë organizative.

Besueshmëri.

2. TITULLI I PUNËS: DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË FURNIZIMIT DHE DISTRIBUIMIT- NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Kryeshefit ekzekutiv

Nr. i Referencës: 02/22

Detyrat dhe përgjegjësitë

Drejton dhe monitoron efikasitetin e kryerjes së punës dhe obligimeve ditore, si dhe bashkëpunon me departamentet tjera, me qëllim të realizimit sa më të mirë të tyre.

Të bashkëpunoj me Drejtorët dhe kolegët tjerë në mënyrë që të siguroj që të gjitha vendimet dhe veprimet e menaxhmentit të ekzekutohen në interesin më të mirë të kompanisë si dhe të krijoj një marrëdhënie bashkëpunimi, kohezioni dhe punë në grupe në mes të stafit dhe palëve tjera relevante.

Udhëheq Departamentin në mënyrë efektive dhe të vepron në të mirën e kompanisë, zvogëlimin të shpenzimeve dhe strategjive operuese.

Është përgjegjës për hartimin dhe elaborimin e një liste ku përfshihen të gjitha kontratat dhe marrëveshjet.

Monitoron dhe kontrollon të gjitha faturimet – kalkulimet para se të dorëzohen në Departamentin e Financave për pagesë.

Bashkëpunon dhe koordinon punët me shërbimet e njësive të ndërmarrjes

Për punët e Departamentit harton raporte të rregullta dhe periodike.

Për kryerje e detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Përgatitje e lartë shkollore, e preferueshme drejtimi Hoteleri dhe Turizem Pese (5) vite përvojë pune. Të ketë edhe përvojë të punës në institucione të ngjashme si Kuzhina Qendrore

Kuptim i shkëlqyer punës së kuzhinës .

Të demonstroj njohuri për kuzhinën, standardet e aplikueshme për këtë rol.

Të ketë njohuri të mjaftueshme të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të zakonshme për punë në Kuzhinë.

Njohja e ndonjë gjuhe të huaj e dëshirueshme.

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit.

Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.

Aftësitë organizative.

Besueshmëri

3. TITULLI I PUNËS: DREJTOR I FINANCAVE - NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv

Nr. i Referencës: 03/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Menaxhon dhe është përgjegjës për departamentin e financave

Menaxhon dhe është përgjegjës në përpilimin e të gjitha planeve të departamentit të Financave, biznes planin, planin buxhetor.

Menaxhon punën e përgjithshme të departamentit dhe ndihmon Kryeshefin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për Departamentin e Financave.

Mbikëqyrë të hyrat nga inkasimi ditor nga shitja, si dhe të hyrat tjera në para të gatshme apo nëpërmjet llogaris së bankës

Menaxhon shpenzimet e përgjithshme të KQ-re në mënyrë që të siguroj likuiditetin adekuat.

Përgatitë planet afat-mesme dhe afatgjata të Departamentit të Financave.

Koordinon punën më të gjitha Departamentet në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që lidhen me Financa.

Përfaqëson KQ te palët e tjera me autorizim të KE

Siguron që niveli i punëtorëve, pajisjet dhe sistemet janë adekuate për përmbushjen e funksioneve të departamentit të Financave.

Siguron që stafi të ketë kualifikimin dhe trajnimet e duhura, mban një pasqyrë për nevojat për trajnime dhe organizon trajnimet e nevojshme.

Sipas procedurave ligjore përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për shërbimet që ofron Departamenti i Financave dhe i procedon në Departamentet tjera sipas manualit të operimit të KQ.

Është përgjegjës për vlerësimin e stafit të vet në baza tre mujore dhe vlerësimin vjetor të secilit të punësuar në Departamentin që menaxhon.

Përgatit planin dhe pasqyrat financiare vjetore, Buxhetin dhe Planin e Biznesit per Bordin.

Përgatitë raportet financiare të ndërmarrjes.

Përgatit analiza dhe statistika financiare mujore dhe vjetore për Departamentin e Financave

Ndihmon në përgatitjet e procedurave dhe akteve tjera nënligjore në lëmin e menaxhimit të financave.

Mbikëqyr hartimin e pasqyrave financiare që kërkohen nga legjislacioni përkatës lidhur me raportet financiare dhe taksat.

Menaxhon kontaktet me ofruesit financiar përfshirë këtu bankat, partnerët financiar dhe donatorët.

Këshillon menaxhmentin e KQ-re lidhur me çështjet financiare.

Kryen punë të tjera që kërkohen nga KE dhe që janë të nevojshme për funksionim efektiv të financave të KQ-re

I raporton Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Diplomë universitare në fushën e ekonomisë ose financave, niveli master ; studimet e Doktoratës në fushat e ngjashme, e preferueshme.

Pesë (5) vite përvojë punë në fushë të ngjashme, minimum tre (3) vite në pozita të larta drejtuese.

E preferueshme përvoja e punës në institucione të ngjashme si Kuzhina Qendrore Kuptim i shkëlqyer punës së kuzhinës .

Të demonstroj njohuri për kuzhinën, standardet e aplikueshme për këtë rol.

Të ketë njohuri të mjaftueshme të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të zakonshme për punë në Kuzhinë.

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit.

Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.

Aftësitë organizative.

Besueshmëri

Aftësi të mira për të përcaktuar prioritetin e detyrave të rëndësishme dhe aftësi për të punuar nën presion dhe në grupe punuese;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Poëer Point, Internet);

Njohja e gjuhës angleze është e preferuar

4. TITULLI I PUNËS: PASTRUES/E - DY (2) VEND PUNE

Departamenti: Departamenti i Administratës

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Udhëheqësit të logjistikës

Nr. i Referencës: 04/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Bën pastrimin e hapësirave, objekteve/mjeteve lëvizëse.

Është përgjegjës që pastrimi i zyrave, objekteve/mjeteve lëvizëse të bëhet në nivelin më të mirë.

Mbanë përgjegjësi për nivelin e pastërtisë në zyre, objekte/mjete lëvizëse.

Bën kërkesën për furnizim të materialit higjienik tek depot e administratës.

Mbanë evidencë për materialin higjienik, shpenzues dhe është përgjegjës që të kujdeset për shpenzimet e higjienës.

Kryen detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi.

Për kryerje e detyrave i përgjigjet shefit të logjistikës.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Shkolla fillore

Së paku një vit përvojë pune relevante

Të ketë aftësi të mira komunikimi

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.

Aftësitë organizative.

Besueshmëri.

5. TITULLI I PUNËS: SHOFER/E- DY (2) VEND PUNE

Departamenti: Departamenti i Administratës

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Udhëheqësit të Logjistikes

Nr. i Referencës: 05/22

Detyrat dhe përgjegjësitë

Shoferi do të ngarkohet me fletë ngarkesë për automjetin –të cilin e drejton.

Drejton automjetin sipas orarit të përpiluar nga udhëheqësi.

T'i respektoj standardet e shërbimit të shpërndarjes së shujtave pran çerdheve dhe bizneseve të kontraktuara

Është përgjegjës për gjendjen teknike dhe paraqitjen e problemeve nga tereni, pastërtinë, furnizimin me karburante dhe lubrifikante.

Pranon dhe liferon shujtat në të gjitha stacionet e caktuara sipas rendit të shërbimit ndaj klientëve të “Kuzhinës Qendrore” duke respektuar standardet e shërbimit.

Është i obliguar që para fillimit të orarit të punës të lajmërohet në punë, për të kontrolluar ujin, vajrat, karburantet, sistemin e ajrit dhe defektet – gërvishtjet tjera

eventuale në automjet dhe para daljes në vijë të marrë pëlqimin është obligative – fletë urdhëresën dhe fletë dërgesën nga udhëheqësi i sektorit të kuzhinës , se automjeti është i gatshëm të dal në vijë.

Plotëson urdhëresën e udhëtimit sipas rregullave të përcaktuara nga KQ.

Nëse konstatohet që nga pakujdesia e shoferit se automjeti ka pasur dëme, atëherë përgjegjësinë do ta bartë vet shoferi.

Shoferi është përgjegjës në respektimin e rregullave të komunikacionit duke u bazuar në ligj mbi sigurinë në komunikacion, duke u bazuar në automjetin se a është teknikisht në rregull.

Shoferi mbanë përgjegjësinë nëse konsumon alkool para dhe gjatë vozitjes, nëse konstatohet nga instancat përgjegjëse.

Kryen detyra tjera të kërkuara nga përgjegjësi.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Shkolla fillore;

Patentë/leje të qarkullimit – se paku kategoria B;

Së paku tre vite përvojë pune relevante;

Të ketë aftësi të mira komunikimi;

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese;

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit;

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit;

Aftësitë organizative;

Besueshmëri.

6. TITULLI I PUNËS: PUNËTOR TEKNIK - NJË (1) VEND PUNE

Departamenti: Departamenti i Administratës

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: - Udhëheqësit të Logjistikes

Nr. i Referencës: 06/22

Detyrat dhe përgjegjësitë

Kryen punët e ngarkimit dhe shkarkimit të përbërësve në depot e Kuzhinës Qendrore që vijnë nga furnizuesit e ndryshëm e të kontraktuar nga NPL Kuzhina Qendrore SH.A.

Asiston shoferin në bartjen e shujtave tek institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës

Benë bartjen e ushqimit të gatshëm nga qendra në automjetet e transportit dhe asiston punë të tjera të përcaktuara nga udhëheqësit e tij.

Kryen edhe të gjitha punët fizike tjera të natyrës së ngjashme të cilat përcaktohen nga udhëheqësit e tij të drejtpërdrejt.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Shkolla fillore;

Të ketë aftësi të mira komunikimi;

Patentë/leje të qarkullimit;

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese;

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit;

Aftësitë organizative;

Besueshmëri.

7. TITULLI I PUNËS: ZYRTAR LIGJOR - NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv

Nr. i Referencës: 07/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Harton dhe zhvillon planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave.

Harton dhe zhvillon, politikën, standardet dhe normat për realizimin e projekteve.

Përgatit dokumentet për projektet përfshirë planin, specifikimet, dokumentacionin dhe koston Financiare.

Harton zbatimin e kontratave për grantet si dhe ndihmon sektorët tjerë në administrimin e kontratave.

Monitoron kontratat mbi realizimin e granteve të financuara nga investitorët.

Harton dhe ndihmon në projektet e përcaktuara nga KQ në koordinim me udhëheqësin e divizionit të menaxhimit të projekteve.

Përgatit dokumentet e nevojshme dhe këshillon udhëheqësin e menaxhimit të projekteve.

Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Diplomë universitare në fushën e shkencave shoqërore, niveli master;

Pesë (5) vite përvojë pune.

E preferueshme përvoja e punës në institucione të ngjashme si Kuzhina Qendrore

Kuptim i shkëlqyer punës së kuzhinës .

Të demonstroj njohuri për kuzhinën, standardet e aplikueshme për këtë rol.

Të ketë njohuri të mjaftueshme të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të zakonshme për punë në Kuzhinë.

Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme.

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese.

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit.

Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës.

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit.

Aftësitë organizative.

Besueshmëri.

8. TITULLI I PUNËS: DEPOIST - NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit të Furnizimit dhe Distribuimit

Nr. i Referencës: 08/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Ben pranimin dhe akomodimin e mallrave ne depo.

Kujdeset për gjendjen reale të mallrave ne depo dhe mbare përgjegjësi për sasinë e mallrave ne depo.

Me kërkesë të personit zyrtar bënë daljen e mallrave nga depot.

Mbanë përgjegjësi për procedurat dhe dokumentacionin e pranimit dhe daljes së mallrave nga depot.

Përkujdeset për sasinë e mallrave në depo dhe në bazë të nevojës bënë kërkesat për furnizim me mallra të depos.

Kujdeset për ruajtjen e të gjithë dokumentacioneve të depos, hyrjes, daljes, kartelat e regjistrimit të mallit etj.

Koordinon dhe mbanë përgjegjësi për personelin që është i angazhuar në depo.

Është përgjegjëse për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe renditjen e mallrave sa më mirë dhe funksional për furnizim. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

Përgatitje e mesme shkollore;

Të ketë aftësi të mira komunikimi;

Patentë/leje të qarkullimit;

Aftësi të forta të punës në ekip dhe aftësi komunikuese;

Niveli i lartë i iniciativës dhe angazhimit;

Mënyrë e strukturuar, e pavarur dhe e zellshme e punës;

Niveli i lartë i angazhimit dhe orientimi ndaj konsumatorit;

Aftësitë organizative;

Besueshmëri.

9. TITULLI I PUNËS: ZYRTAR I PROKURIMIT - NJË (1) VEND PUNE

Kohëzgjatja: 1 vit

Puna provuese: 3 muaj

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv

Nr. i Referencës: 09/22

Detyrat dhe përgjegjësit

Përgatit planin dhe strategjinë e prokurimit për Ndërmarrjen, duke bërë sigurimin e të gjitha kërkesave për prokurim për mallra, shërbime, punë apo shërbime të konsulencës, që të jenë të nënshkruara nga personat e autorizuar dhe të jenë në harmoni me procedurat e prokurimit;

Organizon punën dhe aktivitetet e prokurimit duke siguruar që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullon procedurat e prokurimit në Republikën e Kosovës;

Nënshkruan dokumentacionin zyrtar të prokurimit, përveç të drejtave që i bart dhe siguron që kjo e drejtë nuk është e kufizuar me ndonjë akt juridik zyrtar;

Mban evidenca të kërkesave për prokurim, si dhe bën dosjen dhe arkivimin e tyre;

Ofron këshilla dhe sugjerime për zbatimin e procedurave të prokurimit dhe në bashkëpunim të ngushtë me KE, merr vendime lidhur me problemet që paraqiten me rastin e realizimit të kontratave nga kontraktues të ndryshëm;

Bashkëpunon me personat përgjegjës të departamenteve lidhur me problemet e hartimit të planit të prokurimit, kërkesave për prokurim, problemeve financiare, logjistikës dhe analizon të arriturat, vështirësitë, kufizimet në kuadër të ministrisë nga aspekti i prokurimit;

Kryen edhe punë të tjera në pajtim me detyrat e vendit të punës;

